



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, forestry and rural Development



Broshura:

“MBARËSHTIMI I KAFSHËVE TË IMËTA- DELEVE DHE DHIVE”



KOSOVA DEVELOPMENT CENTER
QENDRA KOSOVARE PËR ZHVILLIM

Address: Dëshmorët e Lirisë nr.135 Gjakovë-Kosovë
Tel: +383 38 724 499 Email: kdc.gjakov@yahoo.com

www.kdc-kosova.org

MBARËSHTIMI I KAFSHËVE TË IMËTA- DELEVE DHE DHIVE

Kjo broshurë është përgatitur nga ekipi i eksperitëve të Qendrës Kosovare për Zhvillim në kuadër të projektit: "Trajnimi i aplikuesve potencial në Programin e garantave të Zhvillimit Rural" e mbështetur nga: MBPZHR dhe ARDP . Broshura shërben për fermerët (blegtorët) që mirren me mbështimin e kafshëve të imëta respektivisht deleve dhe dhive. Doracak apo broshura do ju shërbej fermerëve si udhëzues për kujdesin ndaj kafshëve , metodat e të ushqyerit , kujdesin para dhe pas pjelljes etj.

MBARËSHTIMI I DELEVE

Delja është kafshë e dobishme shtëpiake sepse prej sajë merren prodhime të çmueshme për ushqim të njeriut dhe veshmbathjen e tij. Mishi dhe qumështi janë produkte mjaft me rëndësi dhe me përmbajtje të lartë të lëndëve ushqyese për njeriun. Gjithashtu leshi, lëkura dhe gëzofrat përdoren për veshmbathjen e njeriut. Njëherit leshi është prodhim kryesor i delës i cili përdoret si lëndë e parë në industrinë e tekstilit.



Racat kryesore të deleve që mbarështohen në Kosovë

Racat më të njohura dhe më të përhapura të deleve që mbarështohen në Kosovë janë: Raca Rudë; Raca Bardhoka; Delja Balushë; Delja e Kosovës; Delja e Sharrit; Raca e Virtembergut; Raca Merinos si dhe Metiset (melezet) e ndryshme (më i përhapuri Sharrvirtemberg).

Shumimi i deleve

Aftësia e shumimit të rregullt respektivisht riprodhimi, është veti mjaft e rëndësishme e deles dhe faktor i cili kontribon në efikasitetin e prodhimitarisë. Procesi i shumimit fillon me fekondim, i cili rrjedh me mbarsim natyral dhe artificial.

Afshi seksual (estrusi) - është gjendje specifike fiziologjike që manifestohet në periudhën e shkurtër kohore që zgjat 18-36 orë. Mbarësimi i suksesshëm arrihet vetëm në këtë fazë (në fazën e estrusit). Estrusi lajmërohet vetëm tek krerët të cilët kanë arritur pjekurinë seksuale. Shenjat e jashtme të estrusit tek delet janë pak të shprehura dhe estrusi mund të zbulohet vetëm në prani të dashit. Estrusi zakonisht prap lajmërohet çdo 16-18 ditë që varet nga raca dhe sezoni i ndërzimit. Intervali kohor ndërmjet fillimit të estrusit të parë dhe fillimit të estrusit të dytë quhet cikli estrual. Te ato raca ku estrusi vështirë hetohet atëher përdoret dashi provues (50 dele për një dash). Te delet xhufka estrusi më lehtë hetohet sepse më furishëm manifestohet.

Metodat e ndërzimit

Në praktikë ekzistojnë 4 metoda të ndërzimit.

I egër i lirë
I haremit
Klasor
Individual.

Sa dele do t'i ndërzej një dash varet nga këta faktor:

Aftësia individuale e dashit (kualiteti i spermës)
Mosha e dashit (dashi i ri 20-25 dele, dashi me kondicion optimal 60-70 dele .
Kohëzgjatja e sezonit të ndërzimit.

Dashi shfrytëzohet për ndërzim 5-6 vite.

Barrëshmëria (Graviditeti) dhe pjellja e deleve

Graviditeti i deleve fillon me fekondim dhe mbaron me pjellje. Barrëshmëria te delët mesatarisht zgjat 150 ditë me variacione 145-152 ditë. Fryti zhvillohet në mitër, në fillim fryti zhvillohet ngadalë e rritet nga fundi i mbarshmërisë. Gjatë gjithë kohës së graviditetit me dele duhet patur kujdes, duhet siguruar ushqim cilësor, vendosje të mirë dhe mbrojtje të mirë shëndetësore. Blegëtori, në qoftëse kërkon nevoja, duhet ndihmuar deles gjatë pjelljes e sidomos ta ushqen të porsalindurin me kulloshtë. Në rast se delet i mbajmë në kullosë kur janë barrëse gjithmonë duhet patur kujdes që të kullosin në kullosë të terur. Një javë para pjelljes delet mbarse duhet ndarë nga delet tjera. Objekti për pjellje duhet të jetë i psatër, i ndritshëm dhe me temperaturë 10-12 grad celsius. Në objektet bashkëkohore vendosen edhe bokset e posaçme ku delet së bashku me qengjat qëndrojnë 2-3 ditë e pastaj kalojnë në grupe. Menjëher pas pjelljes qengjin duhet peshuar dhe evidentuar, në fillim shenjuar përkohësisht e pastaj me shenjë të përhershme. Pesha e qengjave të porsalindur sillet prej 2-6 kg, e te disa raca fisnike, mund të jetë edhe diç më e lartë. Lindja e qengjave bineq varet kryesisht nga raca, ku Racat xhufka mund të arrijnë pjellorinë 110% e ato fisnike edhe 250% (delja e Finlandës). Pjelloria, përveç racës, varet edhe nga këta faktorë:

1. Mosha e delës (pjelloria rritet deri në moshën 6 vjeçare e pastaj bie)
2. Stina e vitit (në pranverë fitojmë më shumë bineq e treneq krahasuar me stinët tjera)
3. Cilësia e ushqimit (ushqimi kualitativ, pasardhës kualitativ)

4. Niveli i seleksionimit (delet e fituara nga prindët e plleshëm kanë plleshmëri më të lartë)
5. Teknika e ndërzimit.
6. Gjendja shëndetësore (sëmundjet, abortet etj.).
7. Kushtet e mbarështimit.

Procesi i pjelljes dhe kujdesi për nënën dhe qingjin prej ditës së parë deri në shkëputje nga gjiri

Pjellja mund të ndahet në 3 etapa themelore:

- Qelja (hapja) - zgjat 1-10 orë
- Dalja e frytit - rreth 3 orë (varësisht sa fryte ka)
- Dalja e lëndëve përcjellëse të frytit (1-2 orë).

Pjellje e rregullt konsiderohet kur i riu del me këmbët e para me kokë në mes. Të riu menjëherë duhet psatruar jargën (turinin) dhe duhet lënë nënës ta lëpijë, e nëse këtë nuk e pranon nëna atëher pastrimin duhet ta bëjë bariu, pastaj qengjit duhet prerë kërthizën dhe duhet patur kujdes që qengji ta pijë kulloshtren. Në qoftë se nëna nuk ka qumësht të mjaftueshëm atëher qengjin duhet lëshuar që të thithë tek delja tjetër ose duhet ushqyer në mënyrë artificiale me biberon nga ana e bariut. Menjëher pas pjelljes nënës duhet dhënë ujë të vokët dhe ngapak bimë e më vonë gradualisht fillohet me ushqim cilësor voluminoz dhe të koncentruar. Qengjat ngelin me të ëmat deri në shkëputje. Menjëher pas moshës 10 ditëshe qengjat duhet mësuar që në mënyrë graduale me i ushqye me ushqim të koncentruar dhe ushqim voluminoz kualitativ. Në moshën 2-4 muajshe qengjat ndahen në grupe (femrat e veçuara nga meshkujt).

Prodhimtaria e qumështit (Laktacioni)

Periodha e dhënjes së qumështit nga delet quhet periodha e laktacionit. Sipas shumë hulumtuesve është konsideruar se periodha e laktacionit tek delet, varsisht prej racës dhe kushteve të mbarështimit, zgjat 6-8 muaj. Në gjatësinë e periudhës së laktacionit ndikojnë faktorët gjenetik dhe jogjenetik, dallimet në mes racave dhe dallimet në mes individëve. Racat e seleksionuara për prodhimtari të qumështit gjatë një laktacioni (205 ditë) mesatarisht japin 500 - 600 litra qumësht. Në të kundërtën, racat primitive (xhufkat) gjatë një laktacioni (3 - 4 muaj) japin deri në 40 litra qumësht, ndërkaq racat mishatake japin qumësht vetëm sa për ta ushqyer të riun.

Sa i përket faktorëve jogjenetik, më të rëndësishëm janë:

- a.- Laktacioni me radhë (maksimumi laktacioni 5, e pastaj ulet)
- b.- Cilësia e ushqimit
- c.- Gjendja shëndetësore
- ç.- Kushtet e mbarështimit
- d.- Tipi i pjelljes (delet me bineq dhe treneq japin më shumë qumësht dhe e kundërta)
- e.- Graviditeti (nëse delja mbarsohet gjatë periudhës së laktacionit prodhimtaria e qumështit zvogëlohet).

Sa i përket vetë laktacionit, sasi më e madhe e qumështit merret në muajin e parë dhe të dytë e pastaj gradualisht ulet.

Mjelja e deleve

Mjelja mund të bëhet me dorë dhe e mekanizuar. Me dorë mjelja zgjat rreth 4 minuta (me variacion 3 - 5 minuta, ndërsa me makinë zgjat 1 - 2 minuta. Mjeljen e mekanizuar tek delet për herë të parë në praktikë e kanë aplikuar Francezët në vitin 1930. Sot me makinë mbjelen edhe deri në 500 dele në ditë.

Mishi i deleve

Prodhimtaria e mishit të delës (qengjit), cilësia e tij dhe sasia, varen nga numri i gjithmbarshëm i deleve, vetivtë gjenetike të racave të deleve që kultivohen, kushtet e të ushqyerit dhe të mbarështimit, teknologjia e mbarështimit dhe shumimit, etj. Prodhimtaria e mishit të delës (qengjave) vlerësohet sipas masës trupore para therjes, masës pas therjes dhe masës së trupit të therur. Masa trupore para therjes ka ndikim të dukshëm në sasinë e mishit dhe për këtë arsye preferohet që delet 24 orë para therjes të mos ushqehen dhe të mos pinë ujë. Masa trupore është masa pa organe të brendëshme, pa kokë dhe pa pjesët e poshtëme të këmbëve.

Delet për therje sipas moshës rangohen në këto kategori:

1. Qëngjat që thithin
2. Qëngjat e shkëputur
3. Rrumzat dhe rumzakët
4. Delët dhe deshtë.

Sa i përket kategorizimit në vetë trupin e therur, ekzistojnë 3 kategori:

I - Mishi i kafshës pa gjurin dhe mishi i ijeve (me veshkë dhe dhjamin veshkor)

II - Shpinda , shpatullat dhe qafa

III - Gjoksi, barku dhe gjuri.

Produktet tjera të deles

Gëzofërat - Është prodhim i rëndësishëm i deles që përdoret për veshmbathjen e njeriut. Sidomos janë të çmuar gëzofrat e qengjit dhe ato të qengjit me lesh të dredhur. Gëzofrave iu ipet emri edhe sipas kohës se kur i therin qengjat. Zakonisht qengjat theren në moshën 1 - 3 ditëshe. Therja e qengjave duhet të bëhet shpejt që lëkura të mos pijë gjak, mirë lahet, teret e kripuset. Vlerësimi i gëzofit bëhet pas therjes së qengjit dhe në lëkurë të terur.

Lëkura - Gjithashtu përdoret për veshmbathje nga njeriu. Lëkurërat e deleve sipas kategorive, thirren me emrin e përbashkët lëkurëra të imta. Me lëkurë të zakonshme nënkuptojmë prodhimin e delës së therur e cila fitohet nga delja e therur apo e ngordhur bashk me leshin. Por kjo lëkurë pas përpunimit thirret lëkurë e përpunuar.

Klasifikimi i lëkurës së deleve

Lëkurët ndahen në lëkurë të qengjave dhe lëkurë të deleve. Lëkurët e qengjave mund të jenë lëkurë të qengjave me lesh dhe lëkurë të qengjave pa lesh. I njeiti klasifikim vlen edhe tek lekurat e deleve.

Plehu

Është produkt mjaft i rëndësishëm i cili shfrytëzohet për të ushqyerit e bimëve dhe rritjen e pjellorisë së tokës, por pa të drejtë nuk i jepet rëndësi e duhur.

Një dele gjatë një viti jep 500 - 600 kg pleh, kurse qengji rreth 100 kg pleh. Në sasinë e plehut ndikojnë shumë faktorë, si: kushtet e mbarështimit, sasia dhe lloji i shtrojes, madhësia e deles, moshja e deles, etj.

Objektet për strehimin e deleve

Ferrat e deleve ndërtohen atje ku kushtet ekonomike dhe ekologjike mundësojnë prodhimtari rentabile në dhentari. Së pari duhet hulumtuar drejtimit e prodhimeve në dhentari e pastaj hulumtohen mundësitë për sigurimin e ushqimit gjatë sezonës së dimrit (sanës, sillazhit, ushqimit të koncentruar, etj.). Gjithashtu hulumtohen mundësitë për sigurimin e ujit për pije në kohën kur delet gjenden në kullosë, poashtu hulumtohen mundësitë e plasmanit të produkteve të deles, kapaciteti i fermës si dhe përcaktimi i territorit në të cilin do të ngritet ferma. Territori në të cilin do të ngritet ferma për dele duhet ti mundësojë fermës bashkangjiten e të gjitha objekteve të nevojshme për vendosjen racionale të gjitha kategorive të deleve.

Ferma ndërtohet në vend të kthjellët të kulluar dhe të terur, vend ky që nuk ka rrezik nga ujrat nëntokësore, vend i cili nuk është i ngarkuar me ndërtesa tjera të banimit apo industriale dhe vend i cili siguron sasira të mjaftueshme të ujit për pije në të gjitha stinët. Gjithashtu ferma duhet të vendoset larg rrugës hekurudhore 300-500 metra dhe 200-500 metra larg rrugëve tjera nga kalojnë kafshët tjera dhe më së paku 400 metra larg nga vendbanimi ku banon njeriu.

Për tu ndërtuar ferma për prodhimtari të ndryshme në radhë të parë duhet të përcaktohet tipi i fermës (për riprodhim, mish, lesh, qumësht etj.), duhet gjithashtu të përcaktohet numri i deleve dhe madhësia e kopesë. Kujdes të veçantë e të domosdoshëm duhet kushtuar sigurimit të ushqimit në sezonën e dimrit, për arsye se delet gjenden brenda në fermë (sana, silazhi, kashta, ushqime të koncentruara, etj.).

Koncepti Tekniko-Teknologjik për ndërtimin e fermës(stallës) për dele

Në fermat e vogëla mundësia e organizmit të prodhimtarisë është më e lehtë dhe me shpenzime më të ulëta, ndërsa në fermat e mëdha për kultivimin e deleve organizimi i punës është më i vështirë, prandaj për ta ndërtuar fermën me kapacitet 3000 - 5000 fkrerë, paraprakisht duhet bërë elaboratin teknik e teknologjik të ndërtimit dhe organizmit të prodhimtarisë.

Objektet bashkohore në të cilat organizohet prodhimtaria përfshijnë edhe objektet përcjellëse që janë të domosdoshme për ta organizuar prodhimtarinë. Këto objekte prodhuese të kapacitetit 3000-5000 krerë duhet t'i kenë këto objekte në kuadër të fermës:

1. Materniteti (objekti për pjellje)
2. Objekti për mbajtjen e qengjave deri në shkëputje nga gjiri
3. Objekti për mbajtjen e brezit të ri
4. Objekti për mbajtjen e deshëve për riprodhim
5. Punkti për mbarësim
6. Objekti për shërimin e deleve (ambulanca)
7. Objekti për mjelje me makinë

Rëndësia e të ushqyerit të deleve

Delja është kafshë ripërtypëse që shfrytëzon si burim ushqimor bimët e imëta të kullotave edhe kur këto kanë lartësi 2-3 cm nga toka, madje edhe atëherë kur kullota është ngrënë më parë nga kafshët e tjera. Nga ana tjetër, në kullotë delja shfrytëzon një numër më të madh bimësh sesa kafshët e tjera, siç janë bimët arommatike, ato me gjemba etj. Këto veçori janë të lidhura ngushtë si me ndërtimin anatomik të gojës së deles (e gjatë me buzë të holla, dhëmbë të gjatë të hollë dhe të mprehtë), ashtu dhe me përbërjen e aparatit tretës të saj. Delet e konsumojnë shumë mirë sanën (nga kullota natyrore ose artificiale), kashtërat e të lashtave dhe të bishtajoreve, zharrhokore, rrënjoret, silazhin si dhe të gjitha llojet e ushqimeve të koncentruara. Në krahasim me gjedhin, delja e tret pak më keq celulozën dhe, për pasojë, në aparatit tretës të saj pengohet edhe tretja e lëndëve të tjera organike.

Në sistemin e mbajtjes dhe të shqyerit të deleve është bërë dhe po bëhet një ndryshim cilësor i ndjeshëm. Mund të themi se tani po hiqet dorë nga një të ushqyer krejtësisht ekstensiv dhe kullosor i tyre. Po kalohet kështu në mbajtjen dhe të ushqyerit kullosor-stallor të deles. Ky ndryshim është kushtëzuar sot nga dy

faktorë: kufizimi i sipërfaqes së kullotave për t'i kultivuar ato me kultura intensive dhe përmirësimi racor e specializimi i dhenve. Rritja e prodhimitarisë së dhenve lidhet ngushtë si me përmirësimin racor të tyre ashtu edhe me krijimin e kushteve të përshtatshme të mbarështimit dhe kryesisht me sigurimin e një baze ushqimore të fortë, e cila duhet të mbështetet jo vetëm në kullot, por edhe te bimët foragjere të kultivuara. Sot po përhapen kultura të tilla foragjere për delet që janë të përshtatshme për to dhe që japin rendimente të larta, si jonxha, tërfili, kolza, bari sudanez etj. Sot po hiqet dorë nga shtegtimi i dhenve për në kullotë verore, si për të kufizuar sipërfaqet e tyre, ashtu dhe për një rrugë intensive në rritjen e deles.

Të ushqyerit e qengjave

Rritja e qengjave ka si qëllim kryesor sigurimin e individëve të shëndetshëm, me prodhimtari të lartë në kushtet e vendit ku jetojnë. Deri në moshën 3-javëshe qengjat mbahen mbyllur në stalla të thata, të pastra dhe të ajrosura mirë, kurse nënat e tyre kullosin afër dhe kthehen për të mëmëzuar qengjat, çdo 3-4 orë. Qengjat pas 3-javësh jo vetëm që duhet të dalin në kullotë së bashku me nënat e tyre, por atyre duhet t'u jepet për të konsumuar edhe ushqime të tjera me prejardhje bimore. Me qenë se qengjat lindin me stomak jo të zhvilluar plotësisht dhe në këtë moshë ata nuk mund të përpunojnë ushqime me vëllim, u jepet tërshërë e bluar, e përzier me hime gruri në sasi 20g në ditë. Kjo sasi rritet gradualisht, derisa në kohën e shkëputjes arrijnë në 200 g në ditë. Bari i thatë i cilësisë së mirë, fillohet t'u jepet qengjave krahas koncentratit dhe ushqimit në kullotë. Në zonat malore si ushqim i thatë mund të përdoren edhe gjethet e thata të dushkut dhe të ahut, kurse në zonat që mbillet panxharsheqeri u jepet gjethet e thata të tij. Shkëputja e qengjave para moshës 2-2.6 muaj nuk lejohet, pasi pengon rritjen e leshit dhe ul vlerën racore të tyre. Pas shkëputjes qengjat formojnë tufa të veçanta dhe për ta sigurohen kullota cilësore. Kujdes i veçantë i kushtohet ushqimit të qengjave në periudhën 8-18 muajshe, kur duhet të shtojmë 120-140 g në ditë. Të mësuarit e qengjave me ushqime voluminoze, duke filluar qysh në moshën 15-ditëshe, bën që qengjat të shkëputen në moshën 40-45-ditëshe, duke përdorur bar të thatë, kullotë si dhe një sasi koncentrat prej 200-300 g.

Të ushqyerit e deleve

Në të ushqyerit e deleve duhet të udhëhiqemi nga gjendja fiziologjike e organizmit të tyre dhe konkretisht, të bëjmë një të ushqyer të diferencuar për:

- a) periudhën e parë të mbarshmërisë,
- b) periudhën e dytë të mbarshmërisë,
- c) periudhën e laktacionit dhe
- d) periudhën për përgatitjen e tyre për ndërzim.

a) në periudhën e parë të mbarshmërisë, që përfshin kohën që nga muaji i parë dhe në atë të tretë, të ushqyerit e dhenve është i rëndësishëm, sepse siguron rritjen normale të frytit dhe ruajtjen e gjendjes shëndetësore të deles. Në këtë periudhë, ushqimet kryesore duhet të jenë ushqime e njoma që sigurohen në kullotat hamullore, në hasëllet e përziera, lakra foragjere etj.

b) në periudhën e dytë të mbarshmërisë, pas muajit të tretë e deri në pjellje, rritja e embrionit është e madhe dhe e shpejtë.

c) kërkesat ushqimore për dhentë që kanë pjellë janë më të mëdha, sidomos për ushqime me vlerë proteinike të lartë, pasi, pas pjelljes, ato prodhojnë një sasi të madhe qumështi, për të cilin harxhojnë një pjesë të njaftueshme të lëndëve ushqimore. Rëndësi të veçantë ka balancimi i racionit me proteina. Në këtë periudhë dhenve duhet t'u jepet ujë dy herë në ditë, herët në mëngjes dhe pasdite, gjithmonë pas konsumit të ushqimeve të ashpra dhe silazhit.

d) periudha e përgatitjes së deleve për ndërzim është një fazë e rëndësishme në të ushqyerit e tyre. Për këtë, para fushatës së ndërzimit delet duhet të kullotin në ngastra me tërfil ose jonxhë. Të ushqyerit e mirë të dhenve para ndërzimit siguron një periudhë të shkurtër ndërzimi dhe pjellje që shoqërohet me një

mbarështim të barabartë dhe zbatim të teknologjisë së njëjtë për të gjithë tufën e deleve dhe qengjave të lindur.

Të ushqyerit e deshve riprodhues

Deshtë riprodhues (të racës) zakonisht mbahen në grup më vete. Atyre u sigurohet ushqimi i bollshëm dhe me vlerë të plotë, sepse ata gjatë gjithë kohës duhet të janë në kondicion të mirë. Të ushqyerit e tyre bëhet në dy periudha:

- a)periudha e pushimit dhe
- b)periudha e ndërzimit.

Kullota për deshtë riprodhues duhet të shërbejë jo vetëm për ushqimin, por edhe që të jenë të aftë për ndërzim. Në periudhën e ndërzimit deshtë riprodhues kanë nevojë për ushqim me vlerë të lartë ushqyese si në njësi, ashtu edhe në vlera proteinike. Prandaj, në këtë periudhë, në racionin e tyre përveç përzierjeve të koncentruara në sasi 1-1.5 kg, ushqim të gjelbër dhe sasi jonxhe të mirë, shtohen edhe 2-3 kokrra vezë dhe 12 l qumësht, që plotësojnë shumë mirë kërkesat proteinike. Me këtë racion ushqimor pa 3-4 orë shëtitje në ditë deshtë majen shumë dhe mund të mos ndërzëjnë, prandaj, duke pasur parasysh këtë fakt, në sezonin para dhe gjatë ndërzimit deshve duhet t'u behet medoemos 3-4 orë shëtitje në ditë.

Të ushqyerit stallor dhe kulloror i deleve

Të ushqyerit stallor të deleve bëhet jo vetëm për periudhat e ftohta të vitit dhe në zonat malore të vendit tonë, por edhe në ato periudha të vitit dhe në zonat e ulëta ku tokat janë të zëna me kultura bujqësore dhe, për pasojë, kapaciteti kulloror është i kufizuar, te sigurohet një bazë e mirë ushqimore. Për këto periudha duhet të sigurohen: bar i livadheve natyrore, bar jonxhe ose bishtajore të tjera, kashta e të lashtave sidomos tërshërës dhe elbit, ushqime të koncentruara dhe pak bërsi e thatë panxhari. Përllogaritja e nevojave të këtyre ushqimeve për periudhën e dimrit duhet të bazohet sipas numrit të krerëve të kategorive të ndryshme të deleve, numrit të ditëve që do të mbahen në regjim stallor dhe në normativat ushqimore. Në periudhat mars-qershor dhe gusht-shtator, kur tokat janë të zëna me kultura bujqësore, të ushqyerit e deleve në stalla bëhet me ushqime të gjelbra nga kulturat foragjere të mbjella. Kushtet më të përshtatshme dhe më ekonomike për rritjen e deleve janë kur ato mund të kullojnë gjatë gjithë vitit, ose së paku për 8-9 muaj. Zgjerimi i kapacitetit kulloror të këtyre kullotave, në kushtet e rritjes intensive të deles, nëpërmjet pastrimit të tyre nga drizat, shkurret e dëmshëm, gurët, ndërtimi i lerave për sigurimin e ujit, është një rrugë e shtimit të burimeve ushqimore .

Gjatë kalimit nga të ushqyerit stallor në ato kulloror dhe anasjelltas,duhet të kemi parasysh:

- 1) kalimi i deleve nga regjimi stallor në atë kulloror e anasjelltas duhet të bëhet gradualisht gjatë një periudhe kalimtare që zgjat 10-15 ditë.
- 2) para se të dalin në kullotë, deleve u jepet të konsumojnë pak bar të thatë që të parapërgatiten për të qëndruar në kullotë.
- 3) në kullotë më jonxhë dhe tërfil delet nuk duhet të lëshohen të uritura mund, të shkaktohet fryrja.
- 4) kullotja duhet të bëhet me ngastra.
- 5) në ditët e nxehta me diell e sidomos në mesditë, delet futën në hije, duke zgjatur kohën e kullotjes pasdite e deri vonë në mbrëmje rreth orës 20-22.
- 6) kur kalohet nga regjimi kulloror në atë stallor, në fillim duhet të përdoren ushqime të ashpra cilësore.
- 7) koha e qëndrimit në kullotë zgjatet ose shkurtohet gradualisht, në varësi të kalimit nga regjimi stallor në atë kulloror ose anasjelltas.

MBARËSHTIMI I DHIVE

Dhitë karakterizohen me prodhime (qumësht, mish, lesh, pleh, etj.) që kanë vlerë të lartë ekonomike. Këto prodhime janë të vlefshme si ushqim për njeriun, lëndë e parë për industrinë e veshëmbathjes dhe për të

ruajtur e rritur pjellurinë e tokës. Dhitë e shfrytëzojnë shumë mirë kullosën, livadhet, bjeshkën dhe bimësinë e ulët.

Pasi që Dhitë kanë aparat tretës të tipit ripërtypës, ato i shfrytëzojnë shumë mirë ushqimet voluminoze dhe i shndërrojnë në produkte blegtorale. Gjithashtu duke i shndërruar më mirë se çdo kafshë tjetër shtëpiake, i shfrytëzojnë burimet natyrore (kullosat, gjeteth pyjore, anët e kanaleve, anët e rrugëve etj.) edhe në ambientet ku kafshët tjera nuk arrijnë të sigurojnë ushqim. Prandaj ato janë një sektor i rëndësishëm i blegtorisë.

Pjelloria e dhisë së sotme dukshëm është rritur në krahasim me të egrat, që është shenjë e shtëpizimit. Gjithashtu dhia e sotme ka edhe ndërzim jashtë sezonal. Prekociteti (hershëmëria) i dhisë së butë është dukshëm më i lartë se i dhisë së egër.

Racat kryesore të dhive që mbarështohen në Kosovë

Racat më të njohura dhe më të përhapura të dhive që mbarështohen në Kosovë janë: Raca Ballkanike (e vendit); Raca Alpina; Raca e Sanës dhe Metiset (melezet) e ndryshme.

Shumimi i dhive

Parim i përgjithshëm gjatë zgjedhjes së cjapit është që ai të jetë i hulumtuar në bazë të pasardhësve të tijë, madje edhe pasardhësit të jenë të cilësisë së lartë. Në kopetë e amëzuara të dhive, për secilën dhi caktohet cjapi me cilësi më të larta se të dhive që duhet të mbarësohen.

Zgjedhja e cjepëve për riprodhim, të cilët shërbejnë për mbarësim të dhive që shërbejnë për prodhimtarinë e leshit (kostretit), është me rëndësi që të zgjedhen ata që japin pasardhës me sasi më të lartë të kostretit të përbërë prej fijeve sa më të holla, të gjata dhe që shkëlqejnë (vizëllojnë), kurse pa pjesëmarrjen e fijeve të shkurtëra, të trasha dhe të vrazhda. Gjithashtu me punë të parreshtur selekcionuese duhet që këta pasardhës të orientohen për prodhimtari më të lartë; të qumështit. Është me rëndësi ekonomike që edhe melezet të japin prodhimtari më të lartë.

Ndërzimi dhe mbarësimi i dhive

Para ndërzimit të dhive është e nevojshme që të bëhen përgatitje paraprake. Ndërzimi duhet të kryhet me plan dhe në kohë të caktuar. Duke pasur parasysh që barrësmëria tek dhitë zgjatë 5 muaj, preferohet që fushata e ndërzimit të tyre të organizohet në muajt nëntor - dhjetor, ndërkaq pjella e tyre në muajt prill - maj. Prodhuesit që sigurojnë kushte më të mira të vendosjes dhe ushqimit të bollshëm e cilësor, mund të sigurojnë ndërzim më të hershëm të dhive si dhe pjellë më të hershme të tyre. Është e dëshirueshme që ndërzimi të kryhet në afatin kohor prej 35 deri 40 ditë, në mënyrë që të fitojmë masë trupore sa më të përafërt të pasardhësve dhe të zbatojmë teknologji të njëjtë të mbarështimit të tyre.

Afshi seksual (estrusi) tek dhia është diç më i gjatë krahasuar me delen dhe zgjatë 24 - 48 orë. Brenda kësaj periudhe duhet të kryhet fekondimi dhe farëzimi. Shenjat e kërkesës së dhive për ndërzim janë: shqetësimi, agresiviteti, apetiti zvogëlohet, ënjëttja e organeve seksuale nga edhe rrjedh sekret i jargor (lëngu), etj. Në rastet kur dhia nuk mbarësohet me ndërzimin e parë, atëherë këtë duhet përsëritur pas 2 - 3 javësh. Është e mundur që dhia të pjellë dy herë brenda vitit. Dy javë pas pjelljes dhia prapë ndërzehet, sepse në këtë periudhë përsëritet estrusi. Dy pjellje brenda vitit janë të mundshme nëse dhitë ushqehen mirë, janë të zhvilluara mirë, janë të shëndosha dhe të moshës 2 - 5 vite.

Barrësmëria dhe pjellja e dhive

Barrësmëria tek dhitë zgjat 5 muaj ose 144 - 155 ditë. Në fillim të barrësmisë dhia nuk hetohet fare, sepse deri në muajin e 4 embrioni zhvillohet shumë ngadal. Në muajin e 4 dhe muajin e 5, dhia fillon të

rëndohet, prandaj në këtë periudhë duhet të shtohet kujdesi ndaj sajë, në mënyrë që të shmanget dështimi i tyre. Dhia është e njohur si kafshë që shpesh dështon. Gjithashtu edhe faktorët mekanik (lëndimet e ndryshme) dhe të ushqyerit ndikojnë shumë në rritjen e përqindjes së dështimeve.

Para fillimit të pjelljes së dhive duhet ndërmarrë disa masa tekniko - organizative në mënyrë që të mënjanohej dështimet dhe që të sigurohet pjellja normale e tyre. Në fillim duhet treguar kujdes për sigurimin e strehimit. Në shumë vise ku mbarështohen dhitë ky akt nënvlerësohet dhe për pasojë ndodhin dështimet dhe ngordhjet e kecape të porsalindur. Tek dhitë gjasat për këtë janë shumë më të mëdha se tek delet.

Shenjat e pjelljes tek dhia janë shumë më të çarta nga delja. Një javë para pjelljes, dhia rëndohet shumë, organet gjënitale fryhen dhe varen poshtë. Dhitë para pjelljes janë të plogështa, veçohen nga kafshët e tjera, ulen dhe qohen shpeshë dhe vazhdimisht shikojnë veten nga pas.

Bariu i kujdesëshëm, para fillimit të pjelljes së dhive e siguron jodin, pambukun dhe gërshtë për prerjen e kërthizës së kecit. Pjellja zgjat 5-10 minuta dhe është më e lehtë krahasuar me delet. Kur dhia lindë 2 keca, dalja e kecit të 2-të nuk vonon më shumë se 15 minuta pas të parit. Pas lindjes së kecit duhet bërë lëvizje të lehta dhe i lëshohet dhisë për ta lëpirë. Pasi i lidhet dhe i dezinfektohet kërthiza, keci vendoset për të pirë qumësht tek e ëma. Vëmendje duhet patur në faktin se duhet shtrydhur pikat e para të qumështit për t'i larguar mikrobet që mund të ndodhen në thimtha. Pas pjelljes këshillohet që dhive t'u jepet një përzirje në formë qulli me hime ose ndonjë ushqim tjetër i koncentruar.

Për dhitë e racave me prodhimtari të lartë kujdesi duhet të jetë edhe më i shtuar, sepse kanë kërkesa më të larta ndaj ushqimit dhe mjedisit. Detyrimisht një muaj para pjelljes duhet të ndërpritet mjelja, duhet pakësuar ushqimet e njoma dhe të ulët gradualisht numri i mjeljeve deri në tharjen e plotë. Kjo shërben që dhija të përgatitet për laktacionin e ardhshëm dhe të përdorë rezervat ushqimore për të plotësuar kërkesat e zhvillimit të kecit, në fazën e fundit të zhvillimit embrional dhe pas lindjes.

Nga dhia merren këto prodhime: qumështi, mishi, lëkura, pushi, leshi (kostreti) plehu, etj.

Qumështi - për nga përbërja kimike qumështi i dhisë është më i përafërt me qumështin e lopës. Qumështi i dhisë nuk ka shije të veçantë dhe ndonjë aromë jo të përshatëshme. Erën e rëndë qumështi i dhisë mund ta fitojë vetëm atëherë kur dhitë pleja (ato që milen) mbahen së bashku me cjepët. Atëherë era e padëshirueshme nga cjepët përcillet tek dhitë, të cilat e bartin në qumësht.

Qumështi i dhisë është më cilësorë se i lopës, sepse shumë më lehtë tretet në organizmin e njeriut. Përveç kësaj, ka përqindje diç më të lartë të yndyrës e cila është e shpërndarë në qumësht në pikëza të vogla të yndyrës, të pasura me lëndë minerale, sidomos me kalcium. Kjo përbërje ia rrit vlerën ushqyese dhe e bën shumë më të përshatshëm për të ushqyerit e fëmijëve, pleqve, të sëmurve, etj. Pikëzat yndyrore të këtij qumështi janë shumë të vogla, me diametër rreth 4 mikronë. Karakteristikë është edhe kazeina e qumështit të dhisë të cilën shumë më mirë e pranon dhe e tretë lukthi i njeriut, dhe shumë më lehtë enzimata proteolitike depërtojnë në te dhe e bëjnë më të tretshme. Qumështi i dhisë përdoret si i freskët dhe si i përpunuar (jogurt, kos, djathra të veçantë, etj.).

Mjelja e dhive - fillon me shkëputjen e kecape (e edhave) dhe kryhet me dorë apo me makinë. Dhitë milen në mëngjes dhe në mbrëmje, pas dhënjes së racionit të ushqimit të koncentruar. Në qoftëse mjelja kryhet me makinë, atëherë dhive u jipet sasi e konsiderueshme e ushqimit të koncentruar gjatë mjeljes. Për mjelje me makinë të 1.000 – 1.200 krerëve të dhive, nevoiten 3-4 punëtorë, kurse për mjeljen me dorë 7-8 punëtorë. Gjuu dhe thimthat e dhisë janë më të përshatshëm për mjelje me makinë se tek delja. Masazhi i gjirit para mjeljes është i domosdoshëm, i cili bëhet veçmas për secilën pjesë të gjirit me të dy duart, pastaj i tërë gjiri nga lartë e poshtë. Kur kryhet masazhi i gjirit fshihet me leckë të terur dhe pastaj bëhet mjelja.

Mishi - përveç qumështit edhe mishi i dhisë është jashtëzakonisht i rëndësishëm në të ushqyerit e njeriut. Është kafshë mjaft pjellore dhe jep sasi të konsiderueshme të mishit të kecit. Mesatarisht një dhi në vit jep 40-50 kg mish keci cilësor. Mishi i kecit ka pak yndyrë (më pak se mishi i qengjit) dhe si i pjekur ka shije

dhe aromë mjaftë të këndëshme. Mishi i cjepëve të vjetër ka erë dhe shije të pakëndshme, andaj për ta larguar këtë erë ata së pari duhet të kastrohen, të trashen dhe të theren, e pastaj të përdoren për ushqim. Me qenë se tek krerët e vjetra hetohet erë dhe aromë jo e dëshirueshme, praktikohet që të theren krerët e rinj, kurse ato të vjetrat së pari të largohen nga riprodhimi, pastaj të trashen e tek pastaj të theren. Në rast se përdoret mishi i krerëve të vjetër, atëherë preferohet të përdoret si i përpunuar apo të përzihet me mishra të llojeve të tjera të kafshëve shtëpiake. Mishi i kecit klasifikohet njëjtë sikurse mishi i qengjit dhe është pothuaj i cilësisë së njëjtë me të qengjit (me më pakë dhjam - yndyrë).

Lëkura e dhisë - lëkura e kecase (edhave) ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe në industrinë e lëkurës, sepse nga këto lëkura përfitohen prodhime mjaft të çmueshme, si këpucë, dorëza, çanta të ndryshme, gëzofra, e gjithashtu kanë rëndësi të veçantë për pallto të ndryshme dhe kapela. Lëkura e kecase, gjithashtu ka rëndësi edhe për ndreqjen e instrumenteve të ndryshme muzikore.

Disa dhi autoktone dhe disa dhi të racës fisnike (Angora) kanë bashkë leshi dhe push i cili karakterizohet me cilësi të lartë dhe butësi. Cilësia e pushit është rreth 15-19 mikrometra, ka edhe krerë që japin push me cilësi edhe më të lartë, 10 - 12 mikrometra. Një dhi mesatarisht prodhon në vit rreth 400 - 600 gramë push.

Plehu i dhisë - llogaritet si pleh mjaft cilësor, sepse ka përqindje të ulët të lagështisë dhe për këtë arsye në stallat (fermat) e dhive përdoret më pak kashtë për shtrorë. Përdoret njëjtë sikurse plehu i deleve për plehrimin e tokës.

Objektet për strehimin e dhive

Stallat e dhive preferohet të ndërtohen në vende të thata, ato duhet shtruar me shtrorë cilësore, të bollshme e të thatë, duhet të kenë sipërfaqe të bollshme të dyshemesë, sepse vendi i ngushtë ndikon në goditjet mekanike që sjellin deri te dështimi i tyre.

Sipas qëllimit të shfrytëzimit, stallat për dhi mund të jenë: Stalla për dhitë në prodhim, për dhitë në riprodhim, stallat për mbajtjen e kategorive të reja, stallat për majmëri dhe stallat ku kryhet pjellja. Ndërkaq sipas pamjes së mureve anësore, ato mund të jenë: të mbyllura, gjysëm të mbyllura dhe të hapura. Ferma duhet të ketë edhe shetitoren, ku në ditët me diell, dhitë dalin për të shëtitur. Lugjet për ushqim në Fermat e dhive janë të kombinuar për ushqim voluminoz, silazh dhe ushqim të koncentruar. Ato mund të jenë të ndërtuara nga druri ose edhe nga metali.

Të ushqyerit e dhive

Pavarësisht faktit se dhia nuk është zgjedhëse e ushqimit, ushqimeve që përdoren për të ushqyerit e këti lloji të kafshëve duhet dhënë rëndësi të veçantë, nëse dëshirohet të shfrytëzohet kapaciteti maksimal gjenetik i tyre dhe të arrihet prodhimtari maksimale e qumështit dhe pjellori e lartë.

Në Evropë sot dhia kultivohet për qumësht dhe mish keci të cilësisë së lartë. Në bazë të dhënave të literaturës, dhia për ushqim i shfrytëzon rreth 547 lloje të bimëve që nuk është rasti me asnjë lloj tjetër të kafshëve, as të butë e as të egër.

Llojet e ushqimeve që përdoren në të ushqyerit e dhive

Në të ushqyerit e dhive shfrytëzohen ushqimet e njëjta si tek të ushqyerit e deleve, me sasi diç më të lartë të silazhit. Në të ushqyerit e dhive zakonisht përdoren sana, silazhi, kullota, nënproduktet e industrisë përpunuese dhe ushqimet e koncentruara.

Në vitet me munges të ushqimit, shfrytëzohen: sana, gjethet, silazhi dhe ushqimet e koncentruara. Pangjari i bagëtisë mund t'u jepet dhive në sasi prej 2 - 4 kg në ditë, e silazhi rreth 3 kg në ditë. Patatja e pjekur apo e zier mund t'u jepet 1-2 kg për krerë/ditë. Dhive barrëse gjithashtu u jepen 1-2 kg silazh. Sana cilësore është mjaft e rëndësishme për dhitë që janë në fazën e mjeljes dhe ato që ndodhen në fazën e barrësmërisë (1.5 kg për krerë/ditë), si dhe ushqimet e koncentruara (rreth 0.7 kg për krerë/ditë).

Ky botim është përgatitur me ndihmën e MBPZHR-ARDP. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e organizatës KDC (Qendra Kosovare për Zhvillim), zbatuese e projektit, dhe nuk pasqyron pikpamjet e MBPZHR-së- ARDP-së.



KOSOVA DEVELOPMENT CENTER
QENDRA KOSOVARE PËR ZHVILLIM

Address: Dëshmorët e Lirisë nr.135 Gjakovë-Kosovë

Tel: +383 38 724 499 Email: kdc.gjakov@yahoo.com

www.kdc-kosova.org